



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 2 korrik 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *Ex Parte*

URDHËR

Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores

Prokurori i Specializuar

Xhek Smith

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 86(4) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (“Aktakuza”) së bashku me material provues në mbështetje të pretendimeve faktike dhe një përshkrim të hollësishëm që lidh çdo dokument të materialit shkresor me secilën prej akuzave.²

II. PARASHTRIMET

2. Në Aktakuzë, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) akuzon Hashim Thaçin (“z. Thaçi”), Kadri Veselin (“z. Veseli”), Rexhep Selimin (“z. Selimi”) dhe Jakup Krasniqin (“z. Krasniqi”), (së bashku “të dyshuarit”) për krimet kundër njerëzimit të vrasjes së paligjshme (Pika 8), burgosjes (Pika 2), torturës (Pika 6), përndjekjes (Pika 1), zhdukjes me forcë të personave (Pika 10) dhe për veprime të tjera çnjerëzore (Pika 4) sipas neneve 13(1)(a), (e), (f), (h), (i), (j) të Ligjit, dhe për krimet e luftës të arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm apo arbitrar (Pika 3), trajtimit mizor apo çnjerëzor (Pika 5), torturës (Pika 7) dhe vrasjes së paligjshme dhe

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetari, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim* (“Parashtrimi i Aktakuzës”), 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3 (“Aktakuza”), 2 (“Përmbledhja”) dhe 3 (“Fotografitë”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

vrasjes (Pika 9) sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit dhe nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1976) ("Kodi Penal i RSFJ-së").³

3. Sipas ZPS-së, të dyshuarit kanë përgjegjësi penale individuale në bazë të nenit 16(1)(a) dhe (c) të Ligjit dhe neneve 22, 24, 26 dhe 30 të Kodit Penal të RSFJ-së, sipas rastit, për:

- a) kryerjen, përmes pjesëmarrjes në ndërmarrjen kriminale të përbashkët (në formën e saj bazë dhe të zgjeruar), e krimeve sipas pikave 1-10;⁴ dhe/ose
- b) ndihmën dhe inkurajimin e krimeve sipas Pikave 1-10;⁵ ose për
- c) krimet sipas pikave 1-10 si eprorë.⁶

4. ZPS-ja kërkon, ndër të tjera, që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të konfirmojë Aktakuzën kundër z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi.⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Sipas nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përmbajë emrin dhe të dhënat personale të të dyshuarit, një paraqitje të shkurtër të fakteve të çështjes dhe krimeve për të cilat akuzohet i dyshuari, në veçanti, formën e pretenduar të përgjegjësisë penale sipas nenit 16 të Ligjit në lidhje me krimet e paraqitura në Aktakuzë.

6. Sipas nenit 39(1) të Ligjit dhe rregullës 86(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencën të shqyrtojë Aktakuzën. Gjatë këtij shqyrtimi, në bazë të rregullës 86(4)(b) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës

³ Aktakuza, para. 22.

⁴ Aktakuza, para. 32-51, 68.

⁵ Aktakuza, para. 52, 68.

⁶ Aktakuza, para. 53-55, 68.

⁷ Dorëzimi i Aktakuzës, para. 7(i).

Paraprake mund t'i kërkojë Prokurorit të Specializuar që ta rishikojë Aktakuzën me qëllim që të japë më shumë hollësi për ndonjë prej akuzave ose të gjitha akuzat dhe veprimet konkrete të të dyshuarit, ose të sigurojë më shumë saktësi ligjore, ose më shumë qartësi në paraqitjen e akuzave.

7. Sipas nenit 21(4)(a) të Ligjit, i akuzuari ka të drejtë të informohet pa vonesë dhe me hollësi për natyrën dhe shkakun e akuzave të ngritura kundër tij. Sipas nenit 21(4)(c) të Ligjit, i akuzuari gëzon të drejtën të ketë kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij. Sipas nenit 21(4)(d) të Ligjit, i akuzuari ka të drejtë të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme.

IV. DISKUTIM

A. KONKRETËSIA E AKUZAVE

8. Aktakuza është konfirmimi i synimit të prokurorit për ta sjellë të akuzuarin për gjykim në lidhje me sjelljet e përshkruara në të. Në pajtim me nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përmbajë: (i) emrin dhe të dhënat personale të të dyshuarit; (ii) një paraqitje të shkurtër të fakteve të çështjes, pra, i të gjitha fakteve mbi të cilat bazohen akuzat; dhe (iii) një paraqitje të shkurtër të krimeve për të cilat i dyshuari akuzohet, domethënë, cilësimin ligjor të fakteve të përshkruara. Këto kërkesa pasqyrojnë komponentët thelbësorë të aktakuzës.

9. Nëse konfirmohet, Aktakuza i jep të akuzuarit informacion të mjaftueshëm për të kuptuar qartë dhe plotësisht natyrën dhe shkakun e akuzave të ngritura kundër tij, për t'i mundësuar përgatitje të një mbrojtjeje adekuate.⁸ Për më tepër,

⁸ ECtHR/GJEDNJ, *Mattochia v. Italy*, no. 23969/94, Judgment, 25 korrik 2000, para. 60; Shih gjithashtu, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-143-tENG, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Defence Request Concerning the Time Limit for the Prosecutor to File the Document Containing a Detailed Description of the Charges, 5 tetor 2018, para. 30; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-199, Pre-Trial Chamber II, Decision on the "Prosecution's Request to Postpone the Confirmation Hearing and All Related Disclosure Deadlines", 15 maj 2019, para. 41-42; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/I, Pre-Trial Judge, Decision Relating to the Examination of indictment,

mjaftueshmëria e informacionit mundëson që i akuzuari të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme. Për këtë arsye, kur vlerëson nëse janë përmbushur kërkesat sipas nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(3) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet t'i kushtojë vëmendjen e duhur të drejtave të lartpërmendura të akuzuarit të parapara në nenin 21(4) të Ligjit.⁹

10. Prokurori për zgjedh dhe harton akuzat.¹⁰ Ligji dhe Rregullorja nuk parashohin ndonjë format të caktuar për ta ndjekur ZPS-ja në përgatitjen e aktakuzës dhe në parashtrimin e akuzave në të.¹¹ Megjithatë, neni 21(4)(a) i Ligjit parashikon një garanci minimale, sipas të cilës i akuzuari duhet të informohet “në hollësi”, ndërsa neni 38(4) i Ligjit dhe rregulla 86(3) e Rregullores kërkojnë paraqitje “koncize” të fakteve dhe të krimeve. Kërkesa për të qenë i informuar “në hollësi” dhe “në mënyrë koncize” kërkon që informacioni të jepet me saktësi¹² dhe shkurtimisht, por në mënyrë të plotë, pa u shpërndarë.¹³ Rrjedhimisht, një lexim i kombinuar i

10 qershor 2011 Issued Against Mr Salim Jamil Ayyash, Mr Mustafa Badreddine, Mr Hussein Hassan Oneissi & Mr Assad Hassan Sabra, 28 June 2011, para. 27; ICTR, *Prosecutor v. Ntagerura et al.*, ICTR-99-46-A, Appeals Chamber, Judgment, 7 korrik 2006, para. 22; *Prosecutor v. Nsengiyumva*, ICTR-96-12-I, Trial Chamber, Decision on the Defence Motion Raising Objections on Defects in the Form of Indictment and to Personal Jurisdiction on the Amended Indictment, 12 maj 2000, para. 1, p. 2; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-A, Aktgjykim i Dhomës së Apelit, 23 tetor 2001, para. 88.

⁹ Neni 21(4)(a), (c) dhe (d) i Ligjit pasqyron nenin 6(1), (3)(a) dhe (b) të Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe nenin 14(3)(a), (b) dhe (c) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Shih gjithashtu ECtHR/GJEDNJ, *Pélissier and Sassi v. France*, no. 25444/94, Judgment, 25 mars 1999 [GC], para. 52, 54; *Sejdovic v. Italy*, no. 56581/00, 1 mars 2006 [GC], Judgment, para. 90; Human Rights Committee, *Evelio Ramón Giménez v. Paraguay*, Communication no. 2372/2014, 25 korrik 2018, para. 7.10; *Arsen Ambaryan v. Kyrgyzstan*, Communication nr. 2162/2012, 28 korrik 2017, para. 9.2.

¹⁰ *Po aty*, ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-422-Red, Pre-Trial Chamber II, Decision on the confirmation of charges against Dominic Ongwen, 23 mars 2016, para. 106.

¹¹ Shih, gjithashtu ECtHR, *Pélissier and Sassi v. France*, no. 25444/94, Judgment, 25 mars 1999 [GC], para. 53.

¹² Sipas *Online Oxford English Dictionary*, “në hollësi” do të thotë “zë pas zëri; pjesë për pjesë; në imtësi”, shih, *OED Online* (Oxford University Press, December 2019), gjendet në <https://www.oed.com/search?searchType=dictionary&q=in+detail&searchBtn=Search> (parë për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹³ Sipas *Online Oxford English Dictionary*, “konciz” do të thotë “i shprehur me pak fjalë, i shkurtër dhe gjithëpërfshirës në atë që shpreh; jo i shpërndarë”, shih, *OED Online* (Oxford University Press,

këtyre dispozitave kërkon *konkretësi* dhe *qartësi* në paraqitjen e fakteve të çështjes dhe të krimeve, përfshirë format e përgjegjësisë penale për të cilat janë ngritur akuzat. Vetëm një aktakuzë që i plotëson këto kritere duhet t'i njoftohet zyrtarisht të akuzuarit.

11. Në parim, aktakuza është një dokument që qëndron më vete. Pretendimet faktike mbi të cilat bazohen akuzat, që përfshijnë çështje si: kush bëri çfarë, ku, kur dhe kundër kujt, duhet të përfshihen dhe përshkruhen mjaftueshëm në Aktakuzë. Në veçanti, të akuzuarve nuk duhet t'u kërkohet të konsultohen me dokumente të tjera për të kuptuar dhe lidhur bashkë pretendimet faktike mbi të cilat mbështeten akuzat.

12. Funkzioni i posaçëm i aktakuzës gjën shprehje në një numër dispozitash të ndryshme në Ligj dhe në Rregullore, që zbatohen në faza të ndryshme të procesit. Aktakuza e konfirmuar përkthehet në një gjuhë që i akuzuari e kupton dhe flet, sipas rregullës 86(8) të Rregullores, dhe i jepet të akuzuarit, sipas rregullës 87 të Rregullores. Gjatë paraqitjes së parë të të akuzuarit, akuzat që përmban aktakuza e konfirmuar i lexohen atij në përputhje me rregullën 92(2)(b) të Rregullores. Së fundi, aktakuza e konfirmuar përcakton objektin e gjykimit, sikurse mund të deduktohet nga nenet 39(8) dhe 40(7) të Ligjit dhe rregullat 90, 91, 118(1)(b), 124(2), 130(1) dhe 158(1) e Rregullores.

13. Rregulla 86(3)(a) dhe (b) e Rregullores përcakton që aktakuza duhet të dorëzohet së bashku me materialin mbështetës, konkretisht: (i) materialin provues që mbështet faktet materiale; dhe (ii) një përmbledhje të detajuar, që tregon lidhjen e secilës provë me secilën akuzë, duke iu referuar posaçërisht sjelljes së të dyshuarit lidhur me krimet e pretenduara. Të dyja dispozitat lidhen me kërkesën e paraqitjes së provave që mbështesin faktet materiale, e cila është e

December 2019), gjendet në <https://www.oed.com/view/Entry/38276?rskey=nQeDwC&result=1#eid> (parë për herë të fundit më 30 qershor 2020).

dallueshme nga kërkesa për paraqitjen e hollësishme dhe koncize të fakteve dhe cilësimin ligjor të tyre.¹⁴ Ndonëse materiali provues dhe përmbledhja e detajuar kanë për qëllim të mbështesin akuzat dhe të tregojnë lidhjen e secilës provë me secilën akuzë, ato nuk duhen parë si zëvendësim apo si zgjatim i aktakuzës. Konkretisht, ndonëse është e mundur që nga materiali provues dhe përmbledhja e detajuar të merren hollësi shtesë lidhur me pretendimet faktike që përmban Aktakuza, nuk duhet që, për t'i kuptuar si duhet akuzat, pretendimet faktike të nxirren më së shumti nga përmbledhja. Veçanërisht, në dallim me aktakuzën, Ligji dhe Rregullorja nuk i caktojnë përmbledhjes së detajuar ndonjë funksion të veçantë, përveç atij të paraparë në rregullën 86(3)(b) të Rregullores.

14. Për qëllimet e këtij urdhri, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta trajtojë kriterin e konkretësisë vetëm në lidhje me paraqitjen e fakteve.

1. PARAQITJA E I FAKTEVE

15. Paraqitja e fakteve duhet të bëhet me konkretësi dhe qartësi të mjaftueshme, me qëllim që i akuzuari të informohet për *shkakun* e akuzës, pra, për të gjitha faktet e lidhura me krimet, përfshirë elementët kontekstualë, dhe veprimet dhe mosveprimet e të akuzuarve në lidhje me secilin prej krimeve mbi të cilat bazohet akuza.¹⁵ Rrjedhimisht, duhet të përcaktohen të gjitha faktet që janë të nevojshme

¹⁴ *Po aty*, ICC, *Prosecutor v Katanga dhe Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-1547-tENG, Trial Chamber II, Decision on Filing of a Summary of the Charges by the Prosecutor, 21 tetor 2008, para. 19; *Prosecutor v. Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-2205, Appeals Chamber, Judgment on the Appeals of Mr Lubanga Dyilo and the Prosecutor Against the Decision of Trial Chamber I, 14 korrik 2009 i titulluar "Decision giving notice to the parties and participants that the legal characterisation of the facts may be subject to change in accordance with Regulation 55(2) of the Regulations of the Court", 8 dhjetor 2009, poshtëshënimi 163; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v Stakić/Prokurori kundër Stakiqit*, IT-97-24-A, Dhoma e Apelit, Aktgjykimi, 22 mars 2006, para. 116.

¹⁵ *Shih* ECtHR/GJEDNJ, *Mattochia v. Italy*, no. 23969/94, Judgment, 25 korrik 2000, para. 59; *Penev v. Bulgaria*, no. 20494/04, 7 janar 2010, Judgment, para. 33.

për të përmbushur elementët përbërës të krimeve të pretenduara, përfshirë elementët kontekstualë, si edhe format e propozuara të përgjegjësisë penale.¹⁶

16. Në aktakuzë nuk duhet të bëhen akuza të mjegullta, me idenë se ato mund të qartësohen kur dhe në qoftë se mund të analizohen prova shtesë.¹⁷ Po ashtu, përshkrimet e përgjithshme të sjelljes së pretenduar, pa iu referuar asnjë incidenti konkret, thjesht përmendja e cilësimit ligjor të sjelljes së pretenduar, ose vetëm paraqitja e të dhënave dhe/ose statistikave, nuk mund të thuhet se përmbushin kriterin e konkretësisë. Megjithatë, mund të kërkohen nivele të ndryshme konkretësie, në varësi të natyrës së krimeve dhe rrethanave të çështjes.¹⁸

17. Rrjedhimisht, kur pretendohet se i akuzuari i ka kryer personalisht veprimet që përbëjnë bazën e krimit të paraqitur në aktakuzë, është e nevojshme të jepen, aq sa është e mundur dhe me “saktësinë më të madhe”:¹⁹ identiteti i

¹⁶ *Po aty*, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Laurent Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-572 (OA5), Appeals Chamber, Judgment on the Appeal of the Prosecutor Against the Decision of Pre-Trial Chamber I, 3 qershor 2013, titulluar “Decision adjourning the hearing on the confirmation of charges sipas neni 61(7)(c)(i) të Statutit të Romës”, 16 dhjetor 2013, para. 47.

¹⁷ *Po aty*, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Delić/Prokurori kundër Deliqit*, IT-04-83-PT, Vendimi i Dhomës Gjyqësore, Vendimi për Mocionin e Mbrojtjes që pretendon defekte në formën e aktakuzës dhe Urdhri për Mocionin e Prokurorisë për të ndryshuar aktakuzën, 13 dhjetor 2005, para. 16; *Prosecutor v. Kvočka et al./Prokurori kundër Kvočkës dhe të tjerëve*, IT-98-30/1-A, Dhoma e Apelit, Aktgjykim, 28 shkurt 2005, para. 30; *Prokurori kundër Naletiliqit dhe Martinoviqit*, IT-98-34-A, Dhoma e Apelit, Aktgjykim, 3 maj 2006, para. 25; ICTR, *Prosecutor v. Karemera et al.*, Trial Chamber, Decision on Severance of Andre Rwamakuba and for Leave to File Amended Aktakuza, 14 shkurt 2005, para. 45; ICC/GJPN, *Prokurori v. Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-2205, Appeals Chamber, Judgment on the Appeals of Mr Lubanga Dyilo and the Prokurori against the Decision of Trial Chamber I 14 korrik 2009, me titull “Decision giving notice to the parties and participants that the legal characterisation of the facts may be subject to change in accordance with Regulation 55(2) of the Regulations of the Court”, 8 dhjetor 2009, para. 90-91; SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, SCSL-03-01-A, Appeals Chamber, Aktgjykimi, 26 shtator 2013, para. 41.

¹⁸ *Po aty*, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-143-tENG, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Defence Request concerning the Time Limit for the Prosecutor to File the Document Containing a Detailed Description of the Charges, 5 tetor 2018, para. 30; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-199, Decision on the “Prosecution’s Request to Postpone the Confirmation Hearing and all Related Disclosure Deadlines”, 15 Maj 2019, para. 41-42.

¹⁹ *Po aty*, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Krnojelac/ Prokurori kundër Krnojellacit*, IT-97-25, Dhoma Gjyqësore, Vendim për mocionin paraprak për formën e Aktakuzës së ndryshuar, 11 shkurt 2000, para. 18; *Prokurori v. Blaškić/Prokurori k Blashkiqit*, IT-95-14-A, Appeals Chamber, Judgment, 29 korrik 2004, para. 213. Shih gjithashtu, SCSL, *Prosecutor v. Brima et al. (AFRC case)*, SCSL-2004-16-A, Appeals Chamber, Judgment, 22 shkurt 2008, para. 38.

viktimës(viktimave); vendi dhe data e përafërt e veprimeve të pretenduara; mënyra dhe mjetet me anë të të cilave janë kryer dhe elementi mendor i lidhur me to.²⁰

18. Nga ana tjetër, nëse nuk pretendohet se i akuzuari e ka kryer drejtpërdrejt krimin, apo kur krimet, për nga vetë natyra e tyre, drejtohen kundër një grupi apo një bashkësie njerëzish, të akuzuarve duhet t'u jepet informacion i hollësishëm: sa më shumë që është e mundur, për vendet, kohën dhe numrin e përafërt të viktimave, përfshirë, të dhënat personale të nevojshme për të kuptuar elementët e krimeve; për sjelljen e pretenduar të të akuzuarve që u bë shkas për përgjegjësinë penale të tyre, përfshirë konturet e planit të përbashkët, zbatimin e tij, si edhe kontributin e të akuzuarve në të; elementin mendor të lidhur me to; dhe identitetet e bashkëkryesve të pretenduar, nëse ka dhe në qoftë se dihen.²¹ Gjithsesi, nuk lejohen formulimet e papërcaktuara të fakteve lidhur me veprimet e pretenduara (si për shembull, “duke përfshirë, por jo të kufizuara me” ose “të tilla si”).²²

²⁰ *Po aty*, ICTY/TPNJ, *Prokurori kundër Blashkijit*, IT-95-14-A, Aktgjykimi i Dhomës së Apelit, *Aktgjykimi*, 29 korrik 2004, para. 213; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-3121-Red, Appeals Chamber, Judgment on the Appeal of Mr Thomas Lubanga Dyilo against his Conviction, 1 dhjetor 2014, para. 122-123; *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-143-tENG, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Defence Request concerning the Time Limit for the Prosecutor to File the Document Containing a Përshkrim i hollësishëm i akuzave, 5 tetor 2018, para. 30; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-199, Pre-Trial Chamber II, Decision on the “Prosecution’s Request to Postpone the Confirmation Hearing and all Related Disclosure Deadlines”, 15 maj 2019, para. 41-42.

²¹ *Po aty*, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-143-tENG, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Defence Request Concerning the Time Limit for the Prosecutor to File the Document Containing a Detailed Description of the Charges, 5 tetor 2018, para. 30; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-199, Pre-Trial Chamber II, Decision on the “Prosecution’s Request to Postpone the Confirmation Hearing and All Related Disclosure Deadlines”, 15 maj 2019, para. 41-42; *Prosecutor v. Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-3121-Red, Appeals Chamber, Judgment on the Appeal of Mr Thomas Lubanga Dyilo Against his Conviction, 1 dhjetor 2014, para. 123.

²² *Po aty*, ICC/GJPN, *Prokurori v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-465-Red, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Confirmation of Charges, 16 dhjetor 2011, para. 82-83; *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11-373, Pre-Trial Chamber II, Decision on the Confirmation of Charges Sipas Neni 61(7)(a) dhe (b) të Statutit të Romës, 23 janar 2012, para. 99, 101 dhe 103; *Prosecutor v. Muthaura et al.*, ICC-01/09-02/11-382-Red, Pre-Trial Chamber II, Decision on the Confirmation of Charges, sipas nenit 61(7)(a) dhe (b) të Statutit të Romës, 23 janar 2012, para. 106.

2. PËRFUNDIM

19. Bazuar në sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se informacioni shtesë është i nevojshëm që Aktakuza të plotësojë kriteret e nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(3) të Rregullores.

20. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se aktakuza përmban tri lista që lidhen me vendet e ndalimit që janë përfshirë në akuza (Lista A),²³ rastet e vrasjeve të paligjshme ose të vrasjeve (Lista B),²⁴ dhe rastet e zhdukjeve me forcë të personave (Lista C)²⁵ dhe se të gjitha ofrojnë të dhëna statistikore lidhur me vendndodhjet, kohën dhe numrat/identitetet e përafërta të viktimave të ditura. Vërehet më tej se në pjesën për format e përgjegjësisë penale përfshihet një përshkrim më i hollësishëm i disa pretendimeve faktike të përzgjedhura, ku jepen hollësi për disa sjellje të caktuara të pretenduara që përbëjnë bazën e krimeve, si edhe për përfshirjen e disa prej të dyshuarve.²⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se, në pjesët për krimet bazë,²⁷ ZPS-ja bën një përshkrim të përgjithshëm të pretendimeve në lidhje me rastet e arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm, keqtrajtimit të të ndaluarve, që përfshin torturën, vrasjen dhe zhdukjen me forcë, pa dhënë hollësi të mëtejshme, lidhjen e dukshme, apo dallimin midis vendeve të krimeve të renditura në Listën A-C, qoftë lidhur me kornizën kohore, viktimat, veprimet konkrete që kanë ndodhur në secilën vendngjarje, kryesit e tyre apo të dyshuarit.

21. Ndonëse mund të jetë e dobishme që në Aktakuzë të përfshihen lista apo prova të tjera jo në formën e tekstit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se, në këto rrethana konkrete, Aktakuza nuk përmbush nivelin e kërkuar të konkretësisë në

²³ Aktakuza, f. 25-29.

²⁴ Aktakuza, f. 30-38.

²⁵ Aktakuza, f. 39-40.

²⁶ Aktakuza, para. 41-47.

²⁷ Aktakuza, para. 59-66.

pjesën e paraqitjes së fakteve që ka të bëjë me krimet bazë. Kjo mungesë konkretësie gjithashtu nuk mund të ndreqet përmes duke lexuar paraqitjet e fakteve në Aktakuzë së bashku me listat, duke qenë se ajo përsëri nuk arrin të vendosë në kontekst sjelljen e pretenduar dhe atë të të dyshuarve.

22. Për këtë arsye, Prokurorit të Specializuar i kërkohet të japë më shumë hollësi në paraqitjen e akuzave. Konkretisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kërkon Prokurorit të Specializuar të shohë mundësinë që për çdo krim të përfshirë në Aktakuzë,²⁸ të përshkruajë sjelljen e pretenduar që mendohet se ka ndodhur në vendngjarje, me të njëjtën renditje si përmbledhjen e detajuar,²⁹ përfshirë informacione lidhur me vendndodhjen, datën/periudhën kohore, konturet e sjelljes së pretenduar, identitetin apo përkatësinë e kryesve, identitetin e viktimave, nëse dihet, apo numrin e viktimave dhe përfshirjen personale apo kontributet e të dyshuarve, sipas rastit. Listat mund të mbahen, sepse ofrojnë të dhëna të përgjithshme shtesë.

B. CILËSIMI LIGJOR I AKUZAVE

23. Gjatë shqyrtimit të aktakuzës dhe materialeve mbështetëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund t'i drejtohet Prokurorit të Specializuar dhe t'i kërkojë që ta rishikojë aktakuzën për të siguruar saktësi ligjore, sikurse parashihet në rregullën 86(4)(b) të Rregullores. Kjo përfshin mundësinë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të kërkojë që Aktakuza të përmbajë paraqitjen e saktë (cilësimin ligjor) të krimeve.

²⁸ Aktakuza, para. 57-66.

²⁹ Kjo mund të përfshijë një numër vendndodhjesh që gjenden në një zonë të gjerë gjeografike. Shih, për shembull, Përmbledhja, f. 260, 452.

24. ZPS-ja i akuzon bashkërisht të dyshuarit për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit dhe nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, të përfshirë në nenet 15(1)(a) dhe 16(2) të Ligjit.³⁰

25. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, ndër shkeljet e tjera “të rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohë lufte, konflikti të armatosur apo pushtimi”, neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së parasheh se vrasjet, tortura, trajtimi çnjerëzor, si edhe arrestimet e paligjshme dhe paraburgimi, janë të ndëshkueshme si krime lufte kundër popullatës civile. Duke qenë se neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së përfshin përmes referimit të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme gjatë konfliktit të armatosur, elementët përbërës të krimeve që përfshihen në nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së përkojnë me ata të përmendur më lart sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit.

26. Për këto arsye dhe duke pasur parasysh detyrimin e Dhomave të Specializuara për të gjykuar dhe funksionuar në pajtim me Ligjin si *lex specialis*,³¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kërkon Prokurorit të Specializuar të shohë mundësinë për të zgjedhur nenin 14(1)(c) të Ligjit si bazë parësore dhe të përshtatshme ligjore për krimet e luftës që përmban Aktakuza dhe nenin 16 të Ligjit si bazë ligjore të përshtatshme për format e akuzuara të përgjegjësisë penale. Kjo kërkesë nuk cenon shqyrtimin përfundimtar të akuzave të ngritura kundër të dyshuarve në Aktakuzë.

³⁰ Aktakuza, f. 1 (Hyrja), para. 68.

³¹ Neni 3(2)(b) i Ligjit.

V. VENDIM

27. Sipas rregullës 86(4)(b) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kërkon Prokurorit të Specializuar ta rishikojë Aktakuzën dhe të dorëzojë deri të **premtën, 24 korrik 2020** një Aktakuzë të rishikuar:

- a) që të përfshijë një paraqitje të hollësishme të fakteve ku të përvijohen me më shumë konkretësi akuzat faktike që i korrespondojnë secilit krim, sikurse u përshkrua në paragrafin 22 më lart; dhe
- b) të akuzojë të dyshuarit vetëm sipas neneve 13, 14 dhe 16 të Ligjit.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 2 korrik 2020
Hagë, Holandë.